REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.41, datë 20/07/2005

"PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.28, DT.15/03/2001 "PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT TEKNIK TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT URBAN, PRANË BASHKISË SË TIRANËS", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.14, DT.11/03/2002"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit Nr.8405, dt.17/09/1998 "Për Urbanistikën", neni 25, ndryshuar me ligjin Nr.8453, dt.04/02/1999 "Për disa plotësime në ligjin Nr.8405, dt. 17/09/1998 "Për Urbanistikën", ligjit Nr.8991, dt.23/01/2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8405, dt. 17/09/1998 "Për Urbanistikën", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Në Vendimin Nr.28, dt.15/03/2001, ndryshuar me Vendimin Nr.14, dt.11/03/2002, fjalët "Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Urban" zëvëndësohen me fjalët "Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës" dhe fjalët "Drejtoria e Planifikimit Urban" zëvëndësohen me fjalët "Drejtoria e Politikave Urbane".

2. Pikat 2/h, 2/k, 2/p, 2/q, 2/r të Vendimit Nr.28, dt.15/03/2001 "Për miratimin e përbërjes së Këshillit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Urban, pranë Bashkisë së Tiranës", ndryshuar me Vendimin Nr.14, dt.11/03/2002, shfuqizohen.

3. Në pikën 2 Vendimit Nr.28, dt.15/03/2001, shtohet pika si më poshtë:

   - Një specialist nga Njësia e Planit Rregullues (Anëtar)

4. Gërmat e pikës 2 të Vendimit Nr.28, dt.15/03/2001 "Për miratimin e përbërjes së Këshillit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Urban, pranë Bashkisë së Tiranës", ndryshuar me Vendimin Nr.14, dt.11/03/2002, riemërtohen si më poshtë:

“Përbërja e Këshillit Teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Urbanistikës riformulohet si më poshtë:

a- Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Urbanistikës (Kryetar)
b- Drejtori i Drejtorisë së Politikave Urbane (Zv/Kryetar)
c- Drejtori i Njësisë së Planit Rregullues (Anëtar)
d- Drejtori i Drejtorisë së Urbanistikës Ligjore (Anëtar)
e- Drejtori i Drejtorise së Legalizim Shpronësimeve (Anëtar)
f- Drejtori i Drejtorisë së Projekteve të Infrastrukturës (Anëtar)
g- Jurist (Anëtar)
h- Shefi i Sektorit të Kadastrës Urbane (Anëtar)
i- Shefi i Sekretarisë Teknike të K.RR.T-së (Anëtar)
j- Një specialist nga Njësia e Planit Rregullues (Anëtar)
k- Sekretar dhe Protokollist (Anëtar)

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI